



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.13, datë 31.1.2019

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 49, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të ligjit 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në memon me nr. prot. 34248/1, datë 10.10.2018, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë, si më poshtë:

1. Në pikën 5, pas fjalisë së parë, shtohet paragrafi si më poshtë:

“Tarifa e shërbimit të parkimit administrohet nga Bashkia e Tiranës. Pagesa e tarifës mund të bëhet pranë punonjësve të Tirana Parking ose nëpërmjet mënyrave alternative të pagesës.

Në rastin kur pagesa e tarifës ofrohet nëpërmjet alternativave të pagesës, Bashkia e Tiranës mund të hyjë në marrëveshje me subjektet që ofrojnë këto shërbime. Në rastin kur tarifa e shërbimit të parkimit kryhet nëpërmjet alternativave të tjera të pagesave, komisioni që paguhet nga Bashkia e Tiranës për këtë shërbim, përcaktohet në marrëveshjen e lidhur midis subjektit përkatës dhe Bashkisë Tiranë.

2. Autorizohet Tirana Parking për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme konkurruese, përzgjedhëse dhe nënshkrimin e marrëveshjeve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Tirana Parking për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI